

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

### Përpunimi / *el-Tehdhiib* / التَّهْدِيْب

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"فَلَمَّا أَفَلَ قَالَ لَا أُحِبُّ الْآفِلِينَ"

"Kur ylli perëndoi, tha: 'Nuk i dua ata që perëndojnë.'" (el-En'am, 76)

Përpunimi është një test për fillestarët, ndërsa për praktikuesit e pjekur është një shteg i rrahur. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është përpunimi i shërbimit (adhurimit), në mënyrë që adhurimi:

- Të mos priset nga injoranca<sup>1</sup>
- Të mos njolloset nga rutina<sup>2</sup>
- Të mos bëhet qëllimi përfundimtar i vendosmërisë<sup>3</sup>

Niveli i dytë është përpunimi i gjendjes (*haal*):

- Për të mos u marrë nga rrjedha e dijes<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Sepse injoranca do ta zbkurojë të shëmtuarën dhe do ta shtrembërojë të bukurën. Injoranca të bën ta zgjedhësh të parëndësishmen para superiores dhe të bën të paaftë për dallimin mes kohëve kur duhet të përfitosh e t'i shohësh urdhrat e Zotit tënd dhe kohëve kur duhet ta shohësh dorën e Zotit në kontrollimin e çdo gjëje.

<sup>2</sup> Disa mund të lidhen me akte të caktuara të adhurimit me të cilat janë mësuar dhe të gjejnë rehati në to. Kjo mund t'i bëjë ato akte një qëllim në vetvete, jo mënyrë për të arritur kënaqjen e Allahut. Përtëritja e njetit është e nevojshme gjithmonë.

<sup>3</sup> Ti duhet të aspirosh vazhdimisht përmirësimin e shërbimit ndaj Zoti tënd dhe nuk bën të jesh i kënaqur me gjendjen tënde të adhurimit.

<sup>4</sup> Duke njohur shejhun (el-Harawin), nga historia dhe nga shkrimet e tij na bëhet e qartë se ai nuk kërkon nga ne ta injorojmë shariatën dhe dijen e teksteve (Kuranin dhe Sunetin); ai mund të kërkojë nga ne që t'u shmangemi hollësisht teknike apo vetëbesimit të tepruar në dijen personale apo mbështetjen në të. Shejhu mund t'u

- Për të mos u preokupuar me formalizma<sup>5</sup>
- Për të mos synuar ndonjë interes vetjak

Niveli i tretë është përpunimi i nijetit:

- Duke e dëlirë nga poshtërimi i shtrëngimit<sup>6</sup>
- Duke iu shmangur të metës së plogështisë<sup>7</sup>
- Duke e mbështetur nijetin karshi kundërshtive të dijes<sup>8</sup>

---

jetë referuar edhe rasteve ku dija mund të mos mjaftojë për t'u udhëzuar lidhur me një rast të caktuar. Ky është rasti ku ti mund të llogarisësh në frymëzim (*ilham*) dhe në intuitë (*dhewk*) – siç përmendi edhe Ibn Tejmije – për të gjetur udhëzim. Kjo nuk është frymëzim dhe intuitë që kundërshton dijen, por që plotëson atë.

<sup>5</sup> Domethënë, s'kemi të bëjmë me atë që të dukemi, të flasim a të sillemi në një mënyrë të caktuar, etj. 'Pse' këtu është më e rëndësishme se 'Si'.

<sup>6</sup> Mos bëj marrëdhëniet e tua me Allahun si marrëdhëniet mes një robi dhe një skllavopronari. Ti je rob i Tij dhe Ai është pronari yt, por Ai nuk është skllavopronari yt. Ai është Zoti yt që të do, të shëron e të ruan. Nëse ndihesh i dërrmuar, lehtëso barrën (pa lënë pas dore obligimet) në mënyrë që udhëtimi drejt Tij të mos bëhet i pakëndshëm. *Muxhahede* (përpjekja) duhet të bëhet me kujdes dhe gradualisht. Grahni vetes sate drejt Tij sikurse do t'i grahje një kafshe bartëse në një udhëtim shumë të gjatë.

<sup>7</sup> Duke përtërirë imanin (besimin) dhe vendosmërinë.

<sup>8</sup> Dija që devijon nijetin tënd, nuk bën të ndiqet. Dija që të bën më pak respektues ndaj Zotit dhe të jep liri të tepërt veprimi, është e dëmshme. Dija që të bën dinak dhe më mashtrues, është shkatërruese. Dija që të bën të interesohesh vetëm për shpërblimin dhe ndëshkimin, nuk nxit dashuri (ndaj Zotit).